



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nënkomisioni për Barazi Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.07.2020, ora 13:00.

Drejtojnë mbledhjen:

Bashkim Fino dhe Eglantina Gjermeni

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i mekanizmave të pushtetit vendor në referimin e dhunës në familje.

Të ftuar:

61 kryebashkiakët e Republikës së Shqipërisë

Romina Kuko – Zëvendësministre e Brendshme

Bardhylka Kosipiri – Zëvendësministre e Shëndetësisë

Irida Agollin – Eksperte e UN Women

Adelina Farrici – drejtore e Shoqatës së Autonomisë Vendore

Agron Haxhimihali - drejtues i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë

HAPET MBLEDHJA

Eglantina Gjermani – Përshëndetje të gjithëve, të nderuar kolegë deputetë të dy nënkomisioneve, Nënkomisionit për Çështjet Vendore, që drejtohet nga zoti Bashkim Fino, me të cilin jemi duke e drejtuar së bashku këtë mbledhje, dhe Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas!

Të nderuar kryetarë bashkish, nënkryetarë, përfaqësues të bashkive, faleminderit që jeni pjesë e kësaj mbledhjeje!

Zonja zëvendësministre e Brendshme, Romina Kuko, faleminderit që jeni me ne!

Zonja Bardhylka Kosipiri, zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, si gjithmonë, është bashkë me ne për këtë çështje kaq të rëndësishme. Faleminderit!

Kemi të ftuar, gjithashtu, dy drejtuesit e dy shoqatave të bashkive, Shoqata e Autonomisë Vendore, zonjën Adelina Farrici, dhe zotën Agron Haxhimihali, drejtues i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë. Faleminderit që jeni me ne!

Mbledhja që organizojmë sot është e fokusuar te mënyra e funksionimit të mekanizmit të referimit të viktimave të dhunës. Është një çështje që jo vetëm Ministria e Shëndetësisë dhe qeveria e kanë prioritet, por edhe ne, si parlament, jemi shumë të interesuar dhe të angazhuar dhe kemi kërkuar vazhdimisht kontributin e angazhimin tuaj, si njësi vendore, për rolin dhe përgjegjësinë që keni në këtë fushë, qoftë në parandalimin e saj, qoftë edhe në trajtimin e viktimave të dhunës.

Bashkë me zotën Fino kemi dërguar letra për të gjithë kryetarët e bashkive, duke u kërkuar të krijojnë mekanizmat e referimit të dhunëstek ato bashki që nuk e kishin krijuar, si dhe të rrisnin efikasitetin e këtyre mekanizmave në bashkitë që janë krijuar këto mekanizma të referimit të dhunës.

Jemi të ndërgjegjshëm që problemi i dhunës në familje na prek të gjithëve, sidomos i dhunës ndaj grave, gjithashtu edhe për shifrat, që janë shqetësuese, madje për shkak të pandemisë ka rritje të rasteve të incidencës së dhunës ndaj grave.

Kemi marrë përgjigjet tuaja lidhur me mënyrën se si funksionojnë këto mekanizma të dhunës, lidhur me vështirësitë që ju keni dhe për këtë jemi të ndërgjegjshëm, por, nga ana tjetër, kemi parë edhe raporte që janë bërë për mënyrën si funksionojnë këto mekanizma të referimit të dhunës në të gjitha bashkitë. Raportit të fundit që i kemi referuar është raporti që ka bërë PNUD-i në vitin 2019 në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale.

Pa dyshim, kemi organizuar edhe seanca dëgjimore së bashku me zotin Fino për problematikat dhe kemi nxjerrë një sërë problematikash lidhur me mënyrën se si ky mekanizëm nuk funksionon ashtu siç duhet në të 61 bashkitë, pavarësisht se është detyrim ligjor, pavarësisht se vendimi i Këshillit të Ministrave i ka të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë tuaja si njësi vendore.

Do t'ia jap fjalën zotit Fino dhe më pas do të diskutojmë së bashku për problematikat që janë vënë re dhe mënyrën se si ne mund t'ju ndihmojmë për t'i adresuar dhe çfarë mund të bëjmë më shumë të dyja palët.

Zoti Fino, urdhëroni!

Bashkim Fino – Faleminderit, kolege!

Problemi i kësaj mbledhjeje të përbashkët të dy nënkomisioneve ka të bëjë me atë raport, të cilin kolegja ime e tha, dhe ju, si kryetarë bashkie, e keni marrë.

Ideja e këtij takimi të përbashkët është për të sensibilizuar më shumë kryetarët e bashkive, për hir të së vërtetës, për të qenë më koherentë dhe më korrektë në raportet që vijnë nga institucionet qendrore, të cilat duhet t'i analizojnë në bashkitë e tyre dhe përmes tyre të gjejnë se sa dhe si e kanë organizuar punën për një problem me të vërtetë serioz që ka sot Shqipëria.

Po të luftojmë të gjithë bashkë, natyrisht që do të binin rastet e dhunës në familje, që është detyrë funksionale, në fund të fundit, e bashkive, e kryetarëve të saj, e këshillit bashkiak, sepse bashkitë nuk janë thjesht për të bërë mbledhje, për të ndarë fonde apo edhe për të zgjidhur probleme të infrastrukturës, por kanë edhe probleme të tjera sociale, të cilat janë shumë të rëndësishme dhe duhet të kihen parasysh edhe në të ardhmen.

Kam para një raport, të cilin nuk dua ta nënvizoj, por ka shumë bashki që janë nën nivelin e këtij raporti, që kërkon një angazhim më i madh, ashtu siç ka bashki që vërtetë e kanë marrë seriozisht punën e këtij raporti.

Takimi i sotëm me kolegen Gjermani është thjesht për të sensibilizuar të gjithë kryetarët e bashkive, të cilët falënderoj pjesën më të madhe të tyre, që janë në këtë mbledhje online që po bëjmë bashkërisht, por, natyrisht, ne do të komunikojmë edhe me bashkitë e tjera nëpërmjet dy shoqatave që kemi sot prezent, të cilat i falënderoj, me idenë që ne të kemi kontakte të vazhdueshme.

Pra, të gjitha ato çfarë do të themi sot këtu, natyrisht, do t'i transmetojmë nëpërmjet dy shoqatave për ato bashki, të cilat, pas mbarimit të mbledhjes, grupi i këshilltarëve tanë do t'ua bëjë

me dije dy shoqatave për të informuar kryetarëte bashkive, që nuk i kemi sot prezentë online në këtë mbledhje.

Unë dua t'ju sugjeroja si një bashkëqytetar apo si një ish-kryetar bashkie i vjetër, që, përveç problemeve të punëve të ditës, duhet t'i krijoni hapësirë më të madhe sidomos barazisë gjinore, parandalimit të dhunës në familje, gjë që është shumë e rëndësishme për të forcuar familjet shqiptare.

Kjo është detyra juaj, në fund të fundit, e kryetarëve të bashkive dhe e grupeve të punës. Ndaj, ata njerëz që keni caktuar në strukturat përkatëse, mundohuni të mos i lëvizni herë pas here, siç shkruhet në raport, apo që ata njerëz të jenë të përgjegjshëm që të raportojnë te ju, si kryetarë, një herë në muaj dhe mbledhjet përkatëse të jenë prezentë, sepse kjo është në të mirën tuaj, si kryetarë bashkie dhe ua rrit nivelin kur jeni prezentë dhe e dini situatën e territorit që mbulonit. Të mos bëhemi si të thuash objekt i medieeve, kur ndodhin raste flagrante, që i dënon e gjithë shoqëria shqiptare, ku dashje pa dashje, bëheni edhe ju si kryetarë bashkie, sepse në qoftë se ndodh një incident në një bashki të caktuar, dhe ju si kryetarë bashkie, si këshill bashkie apo si administratë mbani një përgjegjësi morale lidhur me ato që ndodhin në bashkinë tuaj.

Ndaj do t'ju sugjeroja, me mirëkuptimin tuaj, që ta lexoni edhe një herë këtë raport voluminoz, për të vendosur disa piketa apo sqarime me punonjësit që keni apo me grupin e punës. Në qoftë se ju, si kryetarë bashkish, e merrni pak më seriozisht këtë, të jeni të bindur që do të minimizohet çdo gjë dhe natyrisht edhe vartësit apo punonjësit tuaj do të jenë më të azhornuar në trajtimin e këtyre problemeve në bashkëbisedimin me ju, por edhe në lidhjen që duhet të kenë edhe me Ministrinë e Brendshme, edhe me Ministrinë e Shëndetësisë.

Bashkë me kolegen time jemi thjesht në kuadrin e sensibilizimit si dy nënkomisione të rëndësishme të parlamentit shqiptar, qoftë Nënkomisioni i Organeve të Qeverisjes Vendore apo edhe Nënkomisioni i Barazisë Gjinore dhe Parandalimit të Dhunës në Familje, dhe kërkojmë nga ju, pikërisht, këtë lloj sensibilizimi.

Duke ju falënderuar paraprakisht, do të doja, zonja Gjermani, të trajtojmë disa probleme me zëvendësministret që kemi këtu apo edhe me shoqatat apo kryetarët e bashkive që të japin mendimet e tyre në lidhje me këtë raport që kemi para, për të cilin do të donim të bënim një diskutim serioz dhe të kemi mirëkuptim ndaj njëri-tjetrit.

Ju faleminderit!

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti Fino!

Do t'ia kaloj fjalën zonjës Kuko, zëvendësministres së Brendshme, për të na bërë një përmbledhje të shkurtër të problematikave. Në fakt, ne kemi një listë të evidentuar dhe problematikave që keni vënë re do t'i ndajmë gjatë mbledhjes në mënyrë të përmbledhur, më pas do t'ia jap fjalën zëvendësministres së Shëndetësisë, zonjës Kospiri.

Fjala për ju, zonja Kuko.

Romina Kuko—Ju faleminderit, zonja Gjermeni!

Përshëndes të dy bashkëkryetarët e nënkomisioneve!

Përshëndetje të gjithë anëtarëve të bashkive, kryetarëve, nënkryetarëve, gjithashtu edhe deputetëve të nderuar,

Së pari, falënderime për takimin e sotëm! Ky takim është tejet i rëndësishëm, duke pasur parasysh rëndësinë që ka vetë pushteti vendor në parandalimin e dhunës në familje, në fakt ka rolin kryesor, pasi pjesa e parandalimit të dhunës në familje është pikërisht funksioni që kanë bashkitë për parandalimin e këtyre rasteve.

Një nga problemet kryesore që hasim është pjesa e burimeve njerëzore të dedikuara në bashki për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Mekanizmi kombëtar i referimit kërkon njerëz, të cilët janë të shkolluar, të specializuar dhe të dedikuar për atë rol. Pra, ne nuk mund të kemi një person, i cili bën edhe funksionin e juristit, por bën edhe funksionin e koordinatorit të dhunës në familje, por na duhen njerëz që merren në mënyrë të qenësishme me rastet, komunikojnë me policinë dhe krijojnë ato që quhen dosjet e rasteve, të cilat janë të plota dhe na japin mundësinë që këto raste të mos i trajtojmë sa herë që ndodhin, por të kemi një vijimësi të këtyre rasteve.

Duke folur për policinë, duhet që mekanizmat kombëtarë të referimit, të cilat janë të vendosura nëpër bashki, të plotësojnë të dhëna dhe t'i kryqëzojnë ato bashkë me policinë, sepse ndodh që Policia e Shtetit ka të dhënat dhe statistikave të veta, ndërkohë që mekanizmat kanë ndonjëherë të dhënat e tyre, shërbimi social ka informacionet e veta dhe këto nuk kryqëzohen me njëra-tjetrën, gjë që na bën të mos kemi mundësi t'i ndjekim rastet në mënyrë të qenësishme, por, nga ana tjetër, edhe personat që kanë nevojë për këto shërbime të mos gjejnë përgjigjen e menjëhershme.

Një pikë tjetër që do të doja të ngrija është pjesa e përmirësimit të bashkëpunimit jo vetëm me policinë, por gjithashtu edhe me të gjithë aktorët e tjerë. Këtu kam parasysh shërbimet shëndetësore, kolegja Kospiri do ta përmendë këtë pjesë. Megjithatë, ndonjëherë është shumë e

rëndësishme që edhe rastet, të cilat sinjalizohen nga pjesa e mjekëve, duhet të jenë të raportuara si në mekanizmin kombëtar të referimit, ashtu edhe në pjesën e policisë.

Kjo që do të them tani, është për pjesën e bashkive, do të duhet të ketë buxhetim të mirëfilltë sa i përket pjesës së parandalimit të dhunës në familje. Kur flas për pjesën e buxhetimit, nuk e kam fjalën vetëm për shtimin e stafit, por e kam fjalën për krijimin e mundësisë së strehëzave, sepse një nga problemet që kemi për dhunën në familje është pjesa e rehabilitimit të viktimave. Jemi ende mbrapa me krijimin e strehëzave, gjë që mund të adresohet nga bashkitë qoftë nëpërmjet një banese sociale, qoftë duke pasur mundësinë e një bashkëpunimi me shërbimet sociale, duke marrë shërbime nga persona, të cilët mund të shërbejnë, mund të kemi një mjek të dedikuar, pra, një marrëveshje mes aktorëve në nivelin vendor dhe kjo krijon edhe mundësinë e strehëzave.

Gjithashtu, kam një kërkesë për pjesën e koordinatorëve vendorë: duhet të marrin pjesë në vlerësimin e riskut. Policia e Shtetit ka formë të posaçme për vlerësimin e riskut, ku çdo rast i dhunës në familje që raportohet regjistrohet në një formë risku. Pse ndodh kjo? E para, sepse ne duhet të dimë se sa i agravuar është si rast, sepse duhet të kemi një regjistrim për të ditur nëse ky rast i dedikuar mund të na krijojë rrezikshmëri që viktimat e dhunës në familje të humbasë edhe jetën.

Kështu që duhet të kemi parasysh që punonjësit në bashki duhet të jenë pjesë e vlerësimit të riskut, që policia bën për rastet e dhunës në familje.

Gjatë kohës së COVID-19 bashkëpunimi me bashkitë ka qenë shumë pozitiv, sidomos në lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, bashkitë kanë bërë veprimet e tyre, të cilat janë të domosdoshme për këtë pjesë. Megjithatë, është shumë e nevojshme që këtë mekanizëm kombëtar referimi ta kemi të shtrirë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, të kemi njerëzit e duhur, buxhetet e duhura. Jam shumë e sigurt që kryetarët janë të dedikuar në punën e tyre, por kjo është një pjesë shumë e rëndësishme, e cila nuk mund të shihet kurrë si pjesë dytësore e punëve.

Këto ishin pak a shumë disa nga pikat. Unë jam shumë kurjoze të dëgjoj qëndrimin e bashkive sa i përket pjesës së parandalimit të dhunës në familje.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Kuko!

Problematikat që janë pjesë e raportit, janë edhe diskutimet që kemi pasur në seancat dëgjimore, por ama një nga shqetësimet që ka dalë është edhe nga koordinatorët e dhunës në

familje në disa prej bashkive, duke thënë që shpeshherë në stacionet e policisë viktime e dhunës trajtohet pa i thirrur koordinatorët. Kështu që unë kërkoj edhe angazhimin tuaj, edhe rritjen e përgjegjësisë e të motivimit dhe zbatimin e ligjit, që koordinatori për dhunën në familje duhet të jetë patjetër pjesë e vlerësimit të riskut edhe në stacionet e policisë.

Fjala është për zëvendësministren Kospiri.

Më shkruan që ka probleme me kamerën, por me zërin është në rregull.

Zonja Kospiri, më dëgjoni?

Derisa zonja të lidhet me ne, do të vazhdoja edhe dy probleme të tjera, që zonja zëvendësministre tha: përcaktimin e koordinatorëve vendorë për dhunën në familje. Në fakt, nga 61 bashki që kemi, vetëm 1/3 e tyre kanë përcaktuar një koordinator për dhunën në familje, i cili apo e cila merret kryesisht me këtë çështje, të tjerët ose nuk e kanë të përcaktuar një koordinator të dhunës në familje, ose luan disa role njëkohësisht në strukturën e bashkisë.

Bashkim Fino – Ideja është kolege dhe kolegë, kryetarë bashkish, që mekanizmat e koordinimit të referimit zyrtarisht janë ngritur vetëm në 40 bashki, nga 61, ose 65% të tyre.

Më lejoni t'ju them se 21 bashkitë që nuk e kanë ngritur këtë mekanizëm të koordinimit të referimit janë: Malësi e Madhe, Hasi, Fushë-Arrëz, Vau i Dejës, Vora, Rrogozhina, Divjaka, Peqini, Skrapari, Konispoli, Lukova, Pusteci, Maliqi, Kuçova, Ura Vajgurore, Poliçan, Selenicë, Memaliaj, Këlcyrë, Dropull dhe Devoll. Pra, nga raporti vlerësohet se nga 40 bashki në të cilat është ngritur ky mekanizëm, vetëm 35 bashki janë funksionale, domethënë pjesërisht funksionale janë 2 bashki, Kolonja dhe Cerriku, ndërsa nuk funksionojnë në 3 bashki: Kurbin, Librazhd dhe në Pukë. Pra, për zgjidhjen e kësaj problematike duhet të rriten përpjekjet për zgjerimin e mekanizmit të koordinimit në të gjitha bashkitë dhe të konsolidohen ato ekzistueset. Pra, nga 40, duhet të jenë patjetër në 61.

Ndaj unë mendoj se kjo është detyra kryesore dhe themelore e kryetarëve të bashkive, por edhe ata që janë mirë në këtë pikë, duhet të kërkojnë të ndjekin se si ecën puna e mekanizmit të koordinimit të referimit.

Së dyti, çështja që do të trajtoja, që është shumë problematike, është se komitetet drejtuese janë hallka më e dobët në funksionimin e mekanizmit të koordinuar, që kanë një detyrim ligjor të mbledhen në çdo 3 muaj dhe, në fakt, nuk mbledhen fare.

Do t'u kërkoja me këmbëngulje kryetarëve të bashkive, që këto komitete drejtuese të mos jenë hallka e dobët, ne nuk i kemi ngritur kot, por duhet të jenë hallkakryesore, dhe meqenëse kanë

një mbledhje çdo 3 muaj ju duhet të kërkonti dhe ta vini në agjendën e punëve tuaja dhe të punonjësve, që ju keni caktuar për këtë çështje, që të jeni prezent ju, kryetarët e bashkive, në mbledhjet e komiteteve drejtuese.

Për zgjidhjen e kësaj problematike kryetarët e bashkive duhet të luajnë një rol shumë aktiv në nxitjen e këtyre komiteteve, që të marrin përsipër rolin e tyre dhe të bëhen më bashkëpunues në nivel vendor.

Mungojnë protokolle standarde për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, vetëm Bashkia e Tiranës ka hartuar një protokoll të tillë, asnjë bashki tjetër nuk ka hartuar një gjë të tillë.

Sa i përket momentit të tretë, siç e tha edhe zëvendësministrja, unë do të kërkoja nga kryetarët e bashkisë, ngaqë dhe unë vetë jam relator dhe mbështetës juaj në Komisionin e Ligjeve kur vjen puna për projektbuxhetin e vitit, pra për transfertat e pakushtëzuara, bashkitë kanë një mungesë dhe mangësi të theksuar sa i përket buxhetit dhe stafit të posaçëm e të specializuar në njësitë administrative për adresimin e dhunës në familje. Për këtë situatë është e nevojshme të rekomandohen që bashkitë të rrisin buxhetin për të përmirësuar gamën e shërbimeve për mbrojtjen nga dhuna në familje në nivel vendor. Kjo të bëhet nëpërmjet zbatimit të buxhetimit të përgjithshëm gjinor, i cili është i detyrueshëm që nga viti 2017 në nivel vendor. Pra, ju e keni detyrim ligjor.

Nga raporti rezulton se shërbimi më sfidues është ofrimi i strehëzave të emergjencave dhe strehimi nga periudha afatmesme në periudhë afatgjatë. Strehimi i përkohshëm nga 24 deri në 72 orë, që bëni ju, kryetarët e bashkive, ofrohet vetëm në 11 nga 61 bashki. Imagjinoni tani sa dobët është pjesa më e madhe, pra rreth 80% e bashkive nuk e ofrojnë këtë strehim të përkohshëm. Prandaj është i nevojshëm alokimi i buxhetit bashkiak për zhvillimin e paketave të plota për shërbime gjithëpërfshirëse për mbrojtjen nga dhuna në familje. Kjo është një nevojë emergjente, që duhet të trajtohet veçanërisht nga bashkitë e mëdha, me një iniciativë më të lartë edhe në rastet e dhunës.

Nga gjithë ky raport për t'ju bërë sa më të qartë, ndaj jemi në këtë mbledhje, mora 3 momente kryesore, të cilat në qoftë së kryetarët e bashkive, gjithashtu, shoqata pranë bashkive i vënë në agjendën e tyre vetëm këto 3 momente, megjithëse raporti është gjithëpërfshirës dhe ka shumë elemente të tjera, të jeni të bindur se angazhimi si bashki apo i stafeve, por dhe mekanizmave, do të jetë akoma më i lartë në këtë kuptim.

I përmenda bashkitë që nuk janë korrekte për të qenë korrekt në këtë mbledhje të përbashkët, sepse ne kemi dërguar shpesh letra me zonjën Gjermani, ku ju tërheqim vëmendjen dhe i themi se duhet t'i trajtoni këto probleme, por ndonjëherë është mirë që dhe në këto mbledhje *online*, që po zhvillojmë sot besoj, por do të bëjmë dhe një tjetër përpara fundit të këtij viti, të tërheqim vëmendjen se çfarë kemi bërë nga kjo mbledhje në mbledhjen tjetër.

Prandaj, zonja Gjermani, unë i ngrita këto 3 probleme për të hapur oreksin, le të themi, edhe për kryetarët e bashkive, edhe për ata që janë mirë, por edhe për ata që unë thashë se nuk janë korrekte në trajtimin e këtyre problemeve, që të marrim përsipër sot të zgjidhin shumë probleme, që ne pastaj, në momentin që do të bëjmë buxhetimin e vitit 2021, të jemi prezent, dhe kur kërkojnë fonde edhe për grandet e pakushtëzuara, edhe për fonde të tjera, t'i kemi të konkretizuara edhe me këto çështje që ne trajtojmë, si dy nënkomisione shumë të rëndësishme.

Ju faleminderit.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti Fino!

Në fakt, raporti është botuar dhe përmbledh vitin 2019. Mund të kenë ndodhur disa ndryshime dhe kanë ndodhur nga disa bashki, që kanë firmosur marrëveshjen dhe janë në proces të ngritjes së mekanizmit, por sërish nuk janë të 61 bashkitë. Këtu doja të falënderoja PNUD-in, programin e Kombeve të Bashkuara dhe UN Women, që kanë ndihmuar për ngritjen e këtyre mekanizmave, duke i trajnuar kapacitetet nëpër bashki. Ky është një proces në të cilin ne po investojmë për t'u rritur profesionalisht.

Edhe një herë fjala për zonjën Kospiri, nëse mundet.

Ndërkohë, do t'ua jap fjalën përfaqësuesve të bashkive apo dhe shoqatave të bashkive për të dhënë mendimet e tyre apo për të ndarë përvojën e tyre në lidhje me mënyrën e funksionimit të këtyre mekanizmave.

Zonja Farrici, keni kërkuar fjalën ?

Adelina Farrici – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar bashkëkryetarë të nënkomisionit,

Në fakt, dua t'ju falënderoj që në vazhdimësi keni sjellë në vëmendje këtë problematikë, e cila është një çështje shumë sensibil dhe periudha e pandemisë, në fakt, e ka nxjerrë më në pah rëndësinë e këtij funksioni te pushteti lokal.

Pushteti lokal, në fakt, e ka këtë funksion dhe në emër edhe të kryetarëve unë mund të them që ka vëmendjen e bashkisë dhe të kryetarëve në këtë drejtim. Gjithsesi bashki të ndryshme kanë performancë të ndryshme në drejtim të këtij funksioni. Kjo edhe për shumë arsye, të mungesës së stafëve të kualifikuara, të mungesës së buxhetimeve, për problematika të ndryshme, me të cilat janë përballur bashkitë, problemet e emergjencave. Pra, ka pasur përqendrim të vëmendjes në ato prioritete, që kanë qenë më të rëndësishme. Gjithsesi, ne jemi në komunikim të vazhdueshëm dhe, si shoqatë, në fakt, kemi angazhimin tonë për të asistuar dhe për të ndihmuar bashkitë, sepse është detyrim ligjor që 61 bashkitë të krijojnë mekanizmin e referimit të dhunës. Pra, së pari, është plotësimi i një detyrimi ligjor.

Gjithashtu, është shumë e rëndësishme që jo vetëm të ngrihet ky mekanizëm, por të jetë funksional. Unë do ta vija theksin te funksionaliteti. Është shumë e lehtë që kjo kompetencë t'i delegohet dikujt dhe bashkia krijon mekanizmin.

Çështja është funksionaliteti. Ne e dimë sa e rëndësishme dhe sa efekt ka kur i paraprin një problemi, se të kalosh në zgjidhjen e problemit pasi ai ka ndodhur.

Mendoj që bashkitë janë ato institucione që mund t'i paraprijnë problemit, sidomos pasi në bashki janë edhe zyrat e mbrojtjes sociale dhe përkrahjes sociale, të cilat janë në komunikim të vazhdueshëm me grupet vunerabël, me shtresat në nevojë. Ne e dimë shumë mirë që shpeshherë dhuna vjen pikërisht për arsye ekonomike dhe është kryesisht te shtresat në nevojë. Duke qenë se ka një njohje të këtyre shtresave, mund t'i paraprijë, ndoshta edhe të dhunuarit mund të jenë më të hapur dhe ndihen ndoshta më rehat e komodë të komunikojnë me zyrat pranë bashkive. Prandaj është shumë e rëndësishme që personi që merret me dhunën në familje të kuptojë funksionin e tij dhe të kuptojë sa i rëndësishëm është ky funksion dhe t'i paraprijë.

Së dyti, është vetë ky person ose zyra përkatëse, që, sipas përshkrimit të vet të punës, duhet të ndjekë dhe të organizojë një herë në tre muaj takime të komiteteve. Këtu gjen zgjidhje një nga çështjet kryesore, që është koordinimi i institucioneve. T'i paraprihet dhunës në familje dhe të zgjidhësh këto probleme, nuk mund ta bëjnë vetëm institucionet lokale, janë një sërë institucionesh lokale, qendrore, shoqëri civile. Mendoj që ky mekanizëm, ky komitet të përbëhet nga të gjithë këto aktorë, dhe, nëse do të ketë mbledhje periodike, edhe jashtë radhe, kur kërkohet nga bashkia, atëherë mendoj që gjithkush nga këto institucione të bëjë rakordimet dhe do të kemi një sukses në këtë drejtim.

Pra, është e patolerueshme që në momentin që kemi një denoncim në polici, nuk njoftohet punonjësi i bashkisë, ose në momentin që punonjësi i bashkisë i ofron asistencën juridike, ofron edhe asistencën psikologjike dhe e referon rastin te strukturat përkatëse, prokurori apo polici, duhet të ketë vëmendjen e duhur nga këto struktura. Patjetër, që pastaj janë dhe shumë probleme të tjera, të cilat kanë të bëjnë dhe me buxhetimin dhe që unë këtu. Në fakt, kam kënaqësinë t'ju falënderoj, e në veçanti zotin Fino, i cili në vazhdimësi e ka kthyer vëmendjen te pushteti lokal dhe ka qenë një mbrojtës dhe advokues i pushtetit lokal! E dimë shumë mirë që problemet financiare të bashkive vetëm do të vinë duke u thelluar, është globale kjo, dhe jo vetëm për bashkitë.

Kështu që ne duhet të jemi sa më të qartë e sa më të saktë dhe të kërkojmë buxhete të dedikuara, pasi pothuajse në shumicën e bashkive, sepse ndoshta vetëm bashkitë kryesore mund të ketë strehëza dhe shumë pak, janë bashki të limituara, nuk ka strehëza, ku të ofrohet një strehim 24 deri në 72 orë. Pra, janë probleme, të cilat bashkitë e kanë të pamundur ta zgjidhin me buxhetin e tyre.

Ne si shoqatë do të vazhdojmë të ndjekim problemin e kompletimit të të gjithë strukturave dhe, në bashkëpunim edhe me donatorë të ndryshëm, do t'i shtyjmë në drejtim të rritjes së kapaciteteve, pra të të punësuarve te kjo strukturë, pasi është shumë e rëndësishme që secili të kuptojë funksionin e tij, të ketë një përshkrim të saktë të punës dhe të dijë të drejtojë dhe pse jo të orientojë. Jam shumë e sigurt që, nëse zyra përkatëse bën mbledhjen dhe i referon kryetarit të bashkisë, që në atë mbledhje duhet të jetë, është e sigurt që kryetari është aty, në mbështetje për t'u dhënë zgjidhje problemeve.

Eglantina Gjermani - Faleminderit, zonja Farrici, edhe për prononcimin, edhe për angazhimin tuaj!

Në fakt, doja të thosha që u ngrit nga zoti Fino si problem, sepse ka dalë nga raporti dhe nga seancat dëgjimore.

Së pari, mungon një koordinator i dedikuar në pjesën më të madhe të bashkive, së dyti, ata koordinatorë që janë marrin shumë detyra dhe përgjegjësi dhe, e treta, mungesa e buxhetimit të shërbimeve sociale. Prandaj ne ngulim këmbë që në buxhetimin e vitit që vjen bashkitë të kenë buxhetim për shërbime sociale, si një angazhim real për të përmirësuar jetesën e qytetarëve.

Zoti Agron Haxhimihali, fjala është për ju.

Agron Haxhimihali – Përshëndetje!

Edhe unë ndihem mirë që takime të tilla i kushtojnë vëmendje çështjes gjinore në pushtetin vendor. Angazhimi duhet të vijë duke u rritur në këtë kontekst.

Si i shikoj unë nga pikëpamja ime gjetjet e këtij raporti? Në fakt, duhet të themi se është mirë të kemi rezultate 100%, por unë nuk shikoj negativitet të madh edhe për 40 bashkitë, që e kanë mekanizmin, por edhe 20 bashkitë që kanë koordinatorët. Në eksperiencën time në rajon, ne jemi mjaft të konkurrueshëm me bashkitë e tjera. Një lajm i mirë është që pjesa e bashkive të mëdha, pjesa e bashkive qendër qarku, që kanë potencialin, e kanë ndërtuar këtë mekanizëm dhe ky përbën lajm. Sigurisht, është mirë t'i kenë edhe bashkitë e mesme dhe të vogla, por fakti që nuk i kanë, për mua, sa e njoh qeverisjen vendore, as nuk duhet t'i stigmatizojmë këto bashkitë e vogla, as të vëmë kujën se çfarë ka ndodhur në këto bashki, që nuk e kanë mekanizmin e dhunës kundër grave, nuk e kanë koordinatorin, pasi, edhe me aq volum pune sa ato kanë, mendoj se rezultatet e tyre kanë qenë të mira.

COVID-i tregoi se edhe në bashkitë e vogla, ku mungon struktura dhe koordinatori, është menaxhuar mirë situata.

Pra, në këtë kontekst nuk shikoj që 61 bashkitë të jenë problematike në këtë drejtim, edhe pse ju, me të drejtë, dhe zoti Fino synoni t'i kapni 61 bashkitë. Mirë është që edhe secili nga ne, pra atë peshë që ka ...

Bashkim Fino – Agron, ngaqë nuk kemi opozitën, duam t'i bëjmë gjërat më mirë, ndaj kërkojmë maksimumin. Prandaj, nuk bën ndonjë hata të madhe që tërheqim vëmendjen. Mua më vjen mirë që ti i mbron kryetarët e bashkive, por unë kam kritika ndaj tyre, duhet të punojnë më mirë.

Agron Haxhimihali - Kur lajmi është mbështetës nga opozita vlerësohet shumë herë më shumë.

Kuadri ligjor ka ardhur duke u përmirësuar, kuadri institucional, po ashtu.

Tani ka dy gjëra, për të cilat kaloj te fjala juaj, zoti Fino. Kuadri organizativ duhet të thellohet më shumë, me asistencë të të gjithë aktorëve, jo të bashkive të mëdha, por të bashkive të vogla dhe të mesme, të cilat ndërtojnë një model strukture, që mund t'i afrohet natyrës që ka Bashkia e Hasit ose e Pustecit, pra duhet t'ia japin këtë asistencë.

Së fundi, po e mbyll me atë që thatë zoti Fino, që u kërkojmë shumë bashkive. Të themi të drejtën, pas reformës territoriale, në çdo takim që kemi me kolegen time, Adelina, u kërkojmë

pafundësisht detyra dhe përgjegjësi, por të mos harrojmë që vetëm 1% është buxheti i pakushtëzuar që qeveria jep.

Bashkim Fino – Jo, jo.

Agron Haxhimihali - Unë kam shumë besim që fjala juaj për buxhetin e vitit 2021 do të zërë vend dhe diçka do të ndryshojë, me një rritje të konsiderueshme.

Eglantina Gjermani – Zonja Kospiri, fjala për ju, meqë nuk u lidhëm më parë, pastaj zonja Ruseti nga Bashkia e Tiranës dhe zoti Tushe.

Bardhylka Kospiri – Faleminderit!

Ndjesë për shkëputjen, sepse patëm defekt teknik.

E nderuar zonja Gjermani,

I nderuar zoti Fino,

Të nderuar deputetë,

Të nderuara kryetare dhe kryetarë të bashkive,

Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si autoriteti kryesor përgjegjës për çështjet dhe dhunës në familje, por njëkohësisht si mbikëqyrëse në procesin e ngritjeve dhe funksionimit të mekanizmave të koordinuar për bashkitë e vendit, ka qenë pjesë, siç edhe u bë prezent, e përgatitjes së raportit, pra ka bashkëpunuar me grupin për të përgatitur raportin, i cili po diskutohet sot lidhur me analizën e funksionimit të mekanizmave të koordinimit të referimit të rasteve të dhunës në familje.

Rezultatet e marra nga ky raport deri në tetor të vitit 2019: janë 40 bashki që e kanë ngritur këtë mekanizëm ose 64% e të gjitha bashkive në vend, ndërkohë që, për më tej kemi, të dhëna se, që nga dhjetori i vitit 2019, doja të përditësoja, dhe deri tani kemi bashkëpunuar me PNUD-in, e në kuadër të programit të përbashkët të qeverisë shqiptare dhe OKB-së, si edhe me linjën e këshillimit për gratë dhe vajzat për nënshkrimin dhe formalizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit edhe me 11 bashki të tjera. Bashkia e Vaut të Dejës e realizoi vetë këtë proces. Kështu numri i bashkive në të cilat është ngritur mekanizmi ka shkuar në 52, nga 61 bashki gjithsej.

Kjo është një e dhënë premtuese. Ndërkohë kemi 8 bashki, me të cilat ende nuk kemi marrëveshje. Do të doja t' i citoja: Bashkia e Konispoli, Bashkia e Libohovës, Bashkia e Memaliajt, Bashkia e Peqinit, Bashkia e Poliçanit, Bashkia e Pustecit, Bashkia e Skraparit, Bashkia e Vorës. Bashkia Vorë do ta nënshkruajë javën që vjen këtë marrëveshje.

Ndërkohë, vijon procesi i shtrirjes së mekanizmit edhe në bashkitë e tjera deri në fundi i këtij viti dhe në fillimi e vitit tjetër. Kjo do të pasohet edhe me fuqizimin e mëtejshëm të të gjitha mekanizmave, veprime të cilat do të jenë pjesë e strategjisë së re të barazisë gjinore 2021-2025. Aktualisht po punohet me 15 bashki për fuqizimin e mekanizmave të tillë

(Shkëputje interneti)

Fokusi kryesor i trajnimeve ka të bëjë me temat për kuadrin ligjor, fokusimi i dhënieve të njohurive në mënyrën e trajtimit të rasteve, siç është: dhuna seksuale, mekanizmi dhe përgatitja e mjeteve që unifikon mënyrën e të punuarit përmes qasjesh ndërsektoriale e të tjera.

Ndërkohë, lidhur me periudhën e pandemisë, e cila solli problematika të shtuara për dhunën në familje, do të doja të thosha që gjatë periudhës së izolimit denoncimet në polici nuk treguan rritje krahasuar me një vit më parë, nga statistikat tona, por thirrjet drejt linjës kombëtare të këshillimit për gratë dhe vajzat 116, 117, treguan shifra të dyfishuara për muajin prill dhe të trefishuara... *(Shkëputje interneti)* dhe relatorët vendorë në disa bashki kanë pasur vështirësi në menaxhimin e rasteve dhe shpesh kanë qenë në kontakt edhe me sektorët përgjegjës të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, për t'u dhënë zgjidhje situatave të ndryshme. Për një përgjigje efektive, edhe në respektim të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të ofrimit të shërbimeve... *(Nuk dëgjohet)* ndaj grave dhe të dhunës në familje Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale ka hartuar gjatë muajit prill me urdhër të ministres së Shëndetësisë një protokoll, e theksoj, për funksionimin e qendrave rezidenciale publike dhe jopublike që ofrojnë shërbime strehimi për viktimat, të mbijetuarit e dhunës në familje, si dhe për viktimat dhe të mbijetuarit e trafikimit gjatë situatës së pandemisë.

Protokolli i hartuar me specialistë të ministrisë... *(Shkëputje interneti)* në fakt, i ndihmoi ofruesit e shërbimeve dhe strehëzat që të punojnë sa më efektivisht që të jetë e mundur në përputhje me situatën edhe për shkak të masave parandaluese.

Gjithashtu, në trajnimet *online* të organizuara për njohjen dhe zbatimin më mirë të këtyre standardeve, në maj të vitit 2020, me mbështetjen e EWIN-it dhe me 37 përfaqësuese dhe përfaqësues nga Ministria e Shërbimit Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku ekzistojnë strehëzat, si dhe vetë strehëzat, si ato publike dhe jopublike, u diskutua gjerësisht mbi funksionimin e këtij shërbimi dhe përshtatjen e tij me të bashkëjetuarit me COVID-in. Po në këtë kuadër kemi mbështetur gjatë muajit prill 2020 edhe stafin e qendrës ILIRIU për përgatitjen e rregullores së brendshme dhe funksionimit e tij në situatën e COVID-19.

Janë dy protokolle për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje nga anëtarët e mekanizmave të referimit dhe këto protokolle u janë përcjellë gjatë muajit maj 61 bashkive nga ana jonë me qëllimin që të shqyrtohen e të miratohen nga komitetet drejtuese të koordinatoreve dhe të udhëheqin punën tyre të përditshme. Për qartësinë e këtyre protokolleve u organizuan në fund të majit, me mbështetjen e UNDP, edhe dy trajnime *online* me koordinatore dhe përfaqësues të 61 bashkive.

Gjithashtu, ka një sërë urdhrash të ministres së Shëndetësisë, duke u nisur nga muaji shkurt një urdhër i rëndësishëm ka të bëjë me procedurat dhe standardet për punonjësit e shëndetësisë që i shoqëron ata në rastet e dhunës në familje, të dhunës... (*Shkëputje interneti*)

). Në këtë kuadër për njohjen dhe zbatimin e këtyre procedurave dhe të standardeve të veprimit nga data 2 deri më 8 korrik 2020....

Eglantina Gjermeni – Ju iku zëri, keni probleme me internetin me sa duket.

Gelardina Prodan – Më dëgjoni?

Eglantina Gjermeni – Tani po.

Ju lutem, përmbliidheni fjalën tuaj!

Faleminderit!

Gelardina Prodan - ...u zhvillua një cikël trajnimesh me të gjitha bashkitë lidhur me njohjen e këtyre procedurave standarde të veprimit.

Ndërkohë, kemi filluar punën për rishikimin e VKM-së kryesore që kemi lidhur, me ndryshimet e ligjit për masat ndaj dhunës në...

Më falni, ndërkohë kemi rishikimin e VKM-së me nr. 334/2011, duke pasur parasysh edhe rekomandimet e bëra nga ana e nënkomisionit për këtë qëllim, duke u nisur edhe nga takimet e mëparshme. Ndryshimet e ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i tetorit të vitit 2018, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, praktikat në rritje dhe problematikat e dala, kanë sjellë nevojën e rishikimit dhe të plotësimit të kësaj VKM-je.

Janë zhvilluar konsultimet e para, pra është një proces i hapur, si dhe synohet që deri në fund të (*Shkëputje interneti*)

Në fund do të doja të theksoja vetëm disa pika.

Gjatë punës që ministria ka zhvilluar si njësi mbështetëse për njësitë e pushtetit vendor i (*Shkëputje interneti*) punës sonë si rezultat i konsultimeve dhe trajtimeve kemi zhvilluar kemi konstatuar këto pika që lidhen me funksionet (*Shkëputje interneti*)

E para, siç doli edhe nga takimi për... (*Shkëputje interneti*) ky është një problem që duhet të zgjidhet patjetër, kuptohet me ngarkesën e një pune të caktuar, por nuk është e mjaftueshme si kohë pune për menaxhimin e këtyre rasteve.

E dyta, mbledhjet e komitetit drejtues... (*Shkëputje interneti*) nuk janë të mjaftueshme ato që kanë dalë, por për të gjitha institucionet në rang qarku bëhet shumë e vështirë prania e të gjithë anëtarëve të ekipeve teknike ndërdisiplinare në mbledhjet e rregullta mujore.

Një çështje tjetër që ka dalë së fundi, ka të bëjë edhe me ndryshimin e vazhdueshëm të përbërjes së këtyre teknikëve universitarë, i cili është një tjetër problem, sepse kuptohet që ndikon në cilësinë e kapaciteteve dhe situata vështirësohet më tej kur kemi ndryshime të vazhdueshme edhe të kordinatorëve.

Pamundësia për të përditësuar në kohë reale dhe për të hedhur rregullisht të dhënat në sistemin EREVAL, kjo si për shkak të ngarkesës së kordinatorëve, por edhe për faktin se jo të gjithë anëtarët i sjellin të dhënat në kohë.

Aktivitetet informuese sensibilizuese përfshijnë edhe trajnimet që nuk janë bërë ende pjesë e planeve vjetore të bashkive, gjithashtu edhe shërbimet e specializuara dhe buxhetet, e cila është shumë e rëndësishme, kur vijnë me burime financiare të domosdoshme si të veprimtarisë (*Shkëputje interneti*) dhe një pjesë e shërbimeve mbështetëse të specializuara për trajtimin më efektiv të rasteve (*Shkëputje interneti*) të paadresuara për shërbimet dhe për alokimin e kostove të duhura financiare dhe burimeve të tjera njerëzore e infrastrukturore duhet të bëhet pjesë e planifikimit të bashkive, sidomos të reflektohen siç duhen në planin buxhetor afatmësëm në respektim edhe të buxhetit (*Shkëputje interneti*) gjinor që parashikohet në kuadrin ligjor.

Ju faleminderit!

Bashkim Fino – Duke ju falënderuar edhe në emër të Eglantinës, dua t'ju them dy gjëra. Në radhë të parë, ndoshta u nxituam që ta dhamë fjalën kaq shpejt, ndoshta duhej ta merrnit fjalën në fund fare, kur të vinim te kryetarët e bashkive, sepse, duke parë raportin e PNUD-it dhe të ministrisë suaj, mbi bazë të kësaj ne do të shohim më tej. Ne prandaj i bëjmë këto mbledhje për t'ju ndihmuar ju, si dhe kryetarët e bashkive.

Ajo që dua të theksoj është, pasi ju thatë se keni kemi shumë korrespondencë dhe informacion me kryetarët e bashkive, duke u dërguar shkresa zyrtare, se do të ishte mirë që këto informacione t'i ndanit edhe me ne si dy nënkomisione të rëndësishme pranë Kuvendit të Shqipërisë, për të mos harruar një nga detyrat themelore që ka Kuvendi i Shqipërisë, kontrollin

parlamentar. Ky kontroll parlamentar ka të bëjë me ato detyra dhe me atë studim që ju keni bërë, ndaj po e bëjmë edhe këtë takim, kështu që të gjitha ato që ju thatë ishin në kuadrin e raportit dhe ndoshta do të ishte mirë që në përfundim të kishim një mbyllje nga ana juaj për të parë edhe ecurinë e kryetarëve të bashkive.

Gjithsesi, ju falënderoj paraprakisht!

Po ashtu, do të doja që informacionet t'ia vinit në dispozicion si Komisionit të Dhunës ndaj Familjes, edhe Komisionit të Pushtetit Vendor pranë Kuvendit të Shqipërisë, pasi edhe ne jemi pjesë e ndihmës dhe e kontrollit parlamentar.

Fjalën do t'ia jap zëvendëskryetares së Bashkisë së Tiranës në lidhje me raportin e paraqitur dhe më pas kryetarëve të tjerë të bashkive.

Zonja Ruseti, fjala për ju.

E paskeni me jehonë, oshtin ti.

Eglantina Gjermeni – Ndoshta keni ndonjë tjetër brenda zyrës suaj që ka lidhje, sepse duhet vetëm një lidhje dhe jo më shumë.

Po ia japim fjalën zotit Tushe dhe më pas do të lidhemi me ju zonja Ruseti.

Fatos Tushe – Faleminderit, zonja Gjermeni dhe zoti Fino!

E dëgjova me vëmendje raportin e paraqitur nga ju. Me të drejtë zonja Gjermeni u shpreh për mungesën e koordinatorit të dhunës në shumë bashki, por unë kam pasur fatin e mirë që zonjën Gjermeni e kam pasur deputete, por edhe ju, ju kam deputet. Dua t'ju them se në bashkinë e Lushnjës që në datën 01.12.2011 është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për ngritjen e mekanizmit në bashkërendim të punës për referimin e rasteve të dhunës dhe të gjitha institucionet nëpërmjet këtij mekanizmi kanë vendosur nga një person përgjegjës për të referuar rastet e dhunës në familje pranë koordinatorit të dhunës në familje, pranë Drejtorisë së Shërbimit Social në bashki.

Sa i takon marrëveshjes që ju theksuat, kjo marrëveshje është nënshkruar me të gjitha institucionet dhe nuk është vetëm Bashkia e Tiranës, pasi, ju zoti Fino, u shprehët se kjo bashki ka një protokoll dhe bën mbledhje çdo 3 muaj. Dua t'ju them se edhe bashkia e Lushnjës deri në fund të vitit 2019 ka zhvilluar rregullisht mbledhje çdo 3 muaj, si dhe pranë zyrës së Shërbimit Social ndodhet një protokoll me të gjitha rastet e referuara të dhunës dhe në çdo moment që janë paraqitur këto raste ne u kemi ofruar ndihmën tonë me 5 mijë lekë për strehim, si dhe janë futur menjëherë në ndihmën e skemës ekonomike.

Në qytetin e Lushnjës ekzistojnë dhe janë funksionale dy ambiente, një ambient 7-ditor te murgeshat, ku ofrohet ndihmë, ushqim, higjienë dhe përkujdesje për fëmijët deri në momentin e gjetjes së banesës, si dhe një ambient i adoptuar pranë qendrës së fëmijëve me probleme shëndetësore. Pra, këto janë ambiente, të cilat shërbejnë për t'i strehuar sa më shpejt personat në nevojë deri në momentin e gjetjes së banesës. Këtu një rol të veçantë për t'u ardhur në ndihmë këtyre personave luan koordinatori pranë Drejtorisë së Shërbimit Social, të cilët interesohen për gjetjen e ambienteve për strehimin e këtyre personave.

Në lidhje me barazinë gjinore, këtë jua them me bindje, sepse duket sikur po flas për Belulin, në bashki, duke anashkaluar ndërmarrjet, këtë e them me bindje ka më shumë femra sesa meshkuj.

Ju faleminderit!

Bashkim Fino – Keni marrë shembull nga Edi Rama.

Fjalën e ka zonja Ruseti.

Anisa Ruseti – A dëgjohem më mirë tani?

Bashkim Fino – Po, tani dëgjoheni më mirë pa oshëtimë.

Anisa Ruseti – Faleminderit!

Përshëndes të gjithë pjesëmarrësit në këtë takim!

Unë besoj se roli më i madh i bashkive gjatë dy fatkeqësive që kemi pasur, si ajo e tërmetit, por edhe gjatë pandemisë, në fakt ka bërë që ne t'u shërbejmë më shumë zonjave kryefamiljare dhe ndaj atyre, që ne gjykojmë se mund të afektohen më shumë nga dhuna në familje, duke menduar ofrimin e një shërbimi që vjen si parandalim. Do të doja shumë ta theksoja se, sidomos gjatë periudhës së COVID-it, ne kemi ndihmuar rreth 340 zonja me paketa ushqimore apo me shërbime të tjera, për të cilat ato kanë pasur nevojë gjatë kohës së pandemisë, pasi e kanë pasur të pamundur aksesimin e shërbimeve, si dhe kur kanë punë të tjera dhe neve na është dashur t'i ndihmonim në lidhje me pagën e luftës apo me ndihmën ekonomike e kështu me radhë.

Në gjykimin tonë kjo është një nga mënyrat për t'u ardhur në ndihmë, pa shkuar te dhuna në vetvete apo te risku i këtyre kategorive. E njëjta gjë është bërë edhe nëpërmjet sistemit të pikëzimit që ka miratuar qeveria, nëpërmjet Ministrisë së Rindërtimit, e cila lidhet me të gjitha shtëpitë apo përfitimet në pagesa në kesh për programin e rindërtimit. Për fatin tonë të mirë, nuk ka qenë e nevojshme ta vendosnim në dispozicion dhe ta aplikojmë sistemin e pikëzimit, ku gratë kryefamiljare marrin automatikisht më shumë pikë, duke qenë ato më lart në përfitim. Fakti që

kemi buxhete të shëndetshme, sidomos kur e lidhim këtë me rindërtimin, na ka bërë që ne si bashki të jemi pak më komod me këtë proces.

Unë besoj se jo vetëm për Bashkinë e Tiranës, por për të 61 bashkitë, të dyja linjat kombëtare të këshillimit janë një aset shumë i madh për t'u ardhur në ndihmë atyre që kanë nevojë, këtu i referohem Linjës Kombëtare të Këshillimit, ku vetëm për periudhën janar-qershor ka pasur rreth 1250 telefonata dhe raste, ku pjesa më e madhe, pra rreth 60% e tyre, i është referuar Bashkisë Tiranë. Këtu kam parasysh edhe fushatën ndërgjegjësuere që ne vetë bëjmë nëpërmjet njësive administrative, por edhe numrit më të lartë të popullsisë që ka Bashkia e Tiranës, si dhe jemi përpjekur që për të gjitha rastet, të cilat njoftojnë te linja e këshillimi, për shkak të anonimatit, duke e quajtur atë si një linjë disi më miqësore, ku mund të ndajnë problemet e tyre dhe më pas linja na i komunikon ne këto raste. Ne më pas gjykojmë nëse janë për menaxhim ose jo. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me linjën e këshillimit të fëmijëve, ku edhe këtu kemi pasur një numër të rritur të rasteve të referuara, kjo natyrisht për shkak të mbylljes së njerëzve nëpër shtëpi dhe kjo gjë edhe në nivel global ka sjellë një rritje të madhe të numrit të rasteve të dhunës në familje.

Për të qenë të sinqertë, dhuna në familje automatikisht nënkupton gratë dhe fëmijët, shumë pak burrat, për të mos thënë që gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur asnjë rast, të cilin ta kemi trajtuar. Kjo vlen vetëm për këto dy momente, por do të doja t'ju thosha se Bashkia e Tiranës bën takime periodike dhe gjatë kësaj periudhe ka bërë dy takime para fillimit të pandemisë, si dhe 8 takime *online*. Takimet *online* kanë qenë pak më të shpeshta edhe për shkak të dinamikave të ngjarjeve, si dhe disa rasteve specifike që janë dashur të trajtohen, kështu që të gjithë anëtarët e grupit teknik ndërdisiplinor janë thirrur në mbledhje, në takime *zoom* apo në takime të tjera joformale.

Ajo që do të doja t'ju thosha është edhe fakti se mënyra se si e kemi zgjidhur ne. Përveç koordinatorit, i cili është në bashkinë qendër, në të 27 njësitë administrative ka një person të dedikuar, i cili ndjek çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, por edhe të zonjave, sepse në gjykimin tonë rastet nuk mund të trajtohen vetëm nga një person i dedikuar, por janë raste që duhen trajtuar në tërësi. Ne besojmë se duhet një ekip brenda njësisë administrative apo bashkisë, i cili nuk duhet ta konsiderojë që nëse është grua, i takon një personi dhe nëse është fëmijë, i takon një personi tjetër, por duke qenë ata vetë një grup ndërdisiplinor marrin në menaxhim rastin.

Po ashtu, dua t'ju them se mënyra si ne i trajtojmë rastet, veçanërisht ato të grave dhe të vajzave, që janë të dhunuara, është ajo nëpërmjet sistemit tonë të programit të bonusit të qirasë, ku

ne arrijmë të paguajmë deri në 100% bonusin e qirasë, veçanërisht vitin e parë dhe në mënyrë të menjëhershme për zonjat që largohen nga një institucion rezidencial, siç është Qendra Kombëtare e Pritjes së Grave që kanë vuajtur nga dhuna në familje, duke i referuar ato drejt një punësimi të qëndrueshëm. Fakti që Bashkia e Tiranës ka numrin më të madh të bizneseve dhe kompanive që ofrojnë punë, e bën pak më të lehtë për t'i referuar zonjat dhe për t'u gjetur një punë, por po ashtu kemi një marrëdhënie shumë të mirë edhe me Shërbimin Kombëtar të Punësimit.

Po ashtu, dua t'ju them se ajo që ne ndjekim nëpërmjet punonjëseve tona të mbrojtjes së fëmijëve është regjistrimi i fëmijëve të këtyre zonjave në çerdhe, kopshte e shkolla sepse ata kanë nevojë për një shërbim pak më të dedikuar, për shkak të traumës që kanë kaluar nga situata e dhunës që kanë përjetuar.

Komenti i fundit që do të doja të theksoja lidhet me sistemin e koordinimit. Në fakt, zonja Kospiri e përmendi faktin që të gjitha bashkitë kanë detyrimin e plotësimit të sistemit *online*, që quhet EREVAL, kështu që, nëse të gjitha bashkitë do të kenë mundësinë të hedhin dhe të përditësojnë në kohë reale të dhënat në këtë sistem, praktikisht nuk do të duhej të kishin mbivendosje dhe raportimi dhe niveli i nevojave që ka çdo bashki në lidhje me këtë çështje besoj se do të ishte më i lehtë dhe më i adresueshëm nga ministria përkatëse apo nga zonja Kuko.

Në rastin e Bashkisë së Tiranës ndikon edhe fakti që kjo bashki ka një bashkëpunim shumë të mirë me të gjitha komisariatet, por edhe me Drejtorinë e Policisë së Tiranës, me të cilët jemi 24 orë në kontakt me ta për çdo rast që referohet në komisariat, si dhe kur ka nevojë që një psikologe apo një punonjëse sociale të asistojë gjatë momentin të intervistimit apo më pas për menaxhimin e rastit.

Shumë faleminderit!

BashkimFino – Ju lashë të flisnit pak më gjatë për shkak se bashkia juaj është një ndër bashkitë më të mëdha dhe nga puna e mirë e Bashkisë së Tiranës duhet të përfitojnë edhe bashkitë e tjera, si nga mënyra e organizimit që ju keni krijuar për 27 njësitë vendore, edhe në kuadrin e punës që bëni në ekip, e cila është diçka mjaft e mirë.

Edhe këto takime që bëjmë, kolegë të nderuar, janë në kuadrin për ta dëgjuar njëri-tjetrin, për të mësuar nga njëri-tjetri dhe për t'u kordinuar, më pas ju takon juve vetë, edhe si nënkryetare bashkie, për të pasur kontakte dypalëshe me bashkinë e Lushnjës, të Durrësit apo të Elbasanit, për të marrë më të mirën e mundshme edhe në kuadrin e punës së përbashkët.

Edhe një herë ju falënderoj zonja Ruseti!

Kush e kërkon fjalën nga kryetarët e bashkive apo nga përfaqësuesit?

Po, bashkia e Tropojës.

Zonja Gjoka.

Shkurte Gjoka – Përshëndetje!

Bashkim Fino – Përshëndetje!

Shkurte Gjoka – Unë ia lashë radhën nënkryetarit për të folur, por meqë jemitë barazisë gjinore, po flas unë.

Bashkim Fino – Shumë mirë.

Shkurte Gjoka - ...dhe mbrojtjes sociale. Për momentin jam e re në këtë pozicion pune, sepse kam qenë punonjëse e ndihmës ekonomike prej 8 vjetësh, domethënë e njoh mirë këtë problem, që ka barazia gjinore, pra gratë e këtij niveli. Në bashkinë tonë, prej dy vjetësh është ngritur mekanizmi i referimit, i bashkëpunimit për trajtimin e rasteve të dhunës dhe marrëdhëniet në nivel familjar, bashkë me protokollin e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor. Gjatë kësaj periudhe së COVID-19 nuk kemi pasur raste të tilla, situata është mirëmenaxhuar, kanë pasur prioritet të gjitha rastet, si, për shembull, gratë e divorcuara me fëmijë, duke i ndihmuar me pako ushqimore, apo me trajtimin me ndihmë ekonomike. Por problemi që ka bashkia, siç përmendi një koleg i yni përpara, është caktimi i një fondi të veçantë për mirëmenaxhimin e rasteve urgjente, plus nuk ka banesa provizore, qoftë 72-orëshe, apo ditore, ku mund të strehohen, osestrehëza, siç quhen ndryshe këto. Fatmirësisht nuk kemi pasur raste të tilla, por duhet të punojmë më shumë, duhet të ketë një fond i veçantë për menaxhimin e rasteve urgjente. Ndërsa marrëveshja në bashkëpunim me të gjitha strukturat në bashki funksionon dhe në kohën e COVID-19 është mbledhur çdo tre muaj *online*, janë diskutuar rastet, janë verifikuar edhe nëpër njësitë administrative, nëse ka, apo jo dhe fatmirësisht nuk ka pasur raste, vetëm këtë muaj kemi pasur një rast, që ka bërë një kallëzim penal, por e kemi menaxhuar dhe për momentin është në prokurori, vazhdon atje procedurat e veta. Problemi është se nuk kemi qendra qoftë ditore, javore, ose 72-orëshe, as sistemin reval nuk e kemi funksional. Prej dy vitesh është risi në bashkinë tonë, sepse nuk ka qenë më parë, punonjësi social i mirëfilltë i NJMF-së dhe i Barazisë Gjinore, i cili i kryen të dyja funksionet, ai është i mirarsimuar, i plotëson kriteret e profesionit dhe mirëmenaxhon këto situata.

Bashkim Fino – Faleminderit, zonja Gjoka, për të gjithë informacionin që ndave me ne dhe të urojmë suksese në detyrën e re, sepse sapo keni filluar aty! Si ti, si unë mësojmë më shumë nga ky takim i sotëm për mbarëvajtjen e punës.

Kush e do fjalën? A ka kush dëshirë të shprehë mendim rreth këtyre çështjeve? Më thoni kush e do fjalën, se nuk shoh!

Po, kolegja ime Antoneta Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja kryetare, për organizimin e këtij takimi, njëkohësisht falënderoj edhe drejtuesit, kryetarët e bashkive dhe punonjësit, të cilët funksionojnë nëpër bashki, të cilat kanë ngritur sistemin e referimit dhe strehëzat dhe, njëkohësisht, falënderoj të dy zëvendësministret, me të cilat kemi bërë para disa kohësh edhe një dëgjese me organizatat e ndryshme për funksionimin e sistemit të referimit, strehëzave dhe dhunën në familje. Është shumë e rëndësishme që ne, si nënkomision, të monitorojmë procesin në terren, pasi sot shumë bashki dhe drejtues bashkie raportuan për sistemin e referimit, ngritjen, por është shumë i rëndësishëm funksionimi dhe raportimi i rasteve të dhunës në familje. Ne si komision kemi hartuar një program pune dhe në bazë të këtij programi do të jemi të pranishëm në terren në të gjitha bashkitë, të cilat kanë ngritur sistemin e referimit, për të parë nga afër se si funksionon, apo a bashkëpunon ky sistem referimi, që është ngritur me institucionet e tjera të policisë dhe të prokurorisë. Edhe në kohën e pandemisë, ashtu sikundër e tha edhe kryetarja e nënkomisionit, zonja Gjermani, ka pasur raste që janë referuar dhe përfaqësuesja e bashkisë Tiranë dha një numër të konsiderueshëm të rasteve, që janë konstatuar gjatë periudhës së pandemisë. E rëndësishme është që këto strehëza dhe këto sisteme referimi duhet të funksionojnë. Kjo është detyra jonë, gjithashtu monitorimi në terren në të gjitha bashkitë, ku është ngritur dhe funksionon ky... (*Shkëputje interneti*)

Bashkim Fino – Faleminderit, zonja Dhima!

Gjithsesi ajo ishte duke thënë atë që do të thoshim ne në fund të mbledhjes bashkë me zonjën Gjermani, pra që ky takim është paradhënie e të gjithë monitorimit që ne si nënkomisione do të bëjmë në organet e pushtetit vendor, ndaj dhe e bëjmë këtë takim *online*, që kryetarët e bashkive të jenë të gatshëm jo vetëm të na presin, por edhe të kenë rezultate shumë të mira në këtë aksion të madh që kemi ndërmarrë bashkërisht.

Kush dëshiron të flasë?

Eduard Duro.

Eduard Duro – Përshëndetje, të dy bashkëkryetarëve të komisionit!

Unë ju njoftoj që në bashkinë Devoll është ngritur mekanizmi i referimit të dhunës në familje dhe me ndihmën e UNDP-së dhe të zonjës Iris Luarasi kemi ngritur linjën e këshillimit për gra dhe vajza. Jemi në hapat e parë të funksionimit të këtij mekanizmi dhe besoj se do të kemi ta nevojshme asistencën e komisionit edhe pse paraprakisht e kemi vënë në funksion dhe kjo u tregua edhe gjatë periudhës së pandemisë. Ne patëm një funksionim shumë të mirë të linjës së këshillimit për gra dhe vajza.

Ju faleminderit!

Bashkim Fino – Kush e do tjetër fjalën?

Po, është e hapur.

Ervin – Bashkia Elbasan.

Bashkim Fino – Bashkia Elbasan, pastaj e ka fjalën zonja.

Ervin Saraçi – Unë jam Ervini, zëvendëskryetar i bashkisë Elbasan. Në fakt, takimi juaj i sotëm përkon me një takim që ne patëm në orën 11:00 *online*, takimi i Komitetit Drejtues të Mekanizmit Referues. Takimi i drejtohet kryetarit të bashkisë, aty morën pjesë si gjithmonë të gjithë aktorët lokalë, që janë pjesë e marrëveshjes. Bashkia Elbasan besoj se futet te bashkitë e mira në këtë aspekt, ne kemi vite që punojmë në këtë drejtim dhe përpiqemi gjithmonë që t’u përgjigjemi sfidave ashtu si duhet. Në fakt, ne e kemi të përcaktuar prej kohësh koordinatorin, ajo që duam të bëjmë, e kemi biseduar edhe me kryetarin, dhe ai e përmendi sot në takimin që pati, është të ndajmë pozicionin e koordinatorit me nëpunësit gjinor në mënyrë që koordinatori të jetë i fokusuar te puna e tij dhe te koordinimi. Është për t’u vlerësuar shumë fakti që në Elbasan është një atmosferë dhe një bashkëpunim ndërinstytucional, i cili funksionon më së miri. Nuk e di të bashkitë e tjera, por te ne i gjithë mekanizmi funksionon shumë mirë, Komiteti Drejtues po ashtu, kryetari e mbledh gjithmonë komitetin drejtues, gjithmonë aktorët na përgjigjen, prokuroria, policia, gjykata, institucionet e tjera të shërbimit shëndetësor, arsimor, por edhe OJF-të, sepse Elbasani është një ambient ku OJF-të luajnë një rol shumë të rëndësishëm.

Ajo që kemi bërë tjetër është që në njësitë administrative, sidomos në zonat rurale, kemi ngritur ato që quhen sipas ligjit “Për shërbimet sociale” njësitë e vlerësimit të nevojave, që të na mundësojë që, përveç ekipit qendror që kemi në zyrat e bashkisë në Elbasan, të kemi edhe ekipet tona në terren, të cilët do të bëjnë vlerësimin e rasteve, në mënyrë që edhe ne t’u përgjigjemi shpejt problematikave që ka në këtë aspekt. Ka qenë një sfidë e madhe sidomos në këtë kohë virusi,

jemi munduar të përgjigjemi. Nga janari deri në qershor kemi pasur gjithsej 83 raste të dhunës në familje, pra me bazë gjinore dhe të gjitha rastet kanë marrë këshillim. Në fakt, numri është pak a shumë njëlloj me numrin e vjetër, megjithëse sfida ka qenë pak më e madhe.

Këto doja të thosha unë.

Faleminderit, për takimin!

Bashkim Fino – Fjalën e ka kërkuar më duket Ridvana.

Ridvana Hysenbelliu – Quhem Ridvana Hysenbelliu, jam nga bashkia Skrapar.

Bashkim Fino – Urdhëroni!

Ridvana Hysenbelliu – Përshëndetje të gjithëve!

Ne në vitin 2017 kemi bërë një marrëveshje bashkëpunimi dhe kemi ngritur mekanizmin e referimit. Nuk e di pse është referuar që ne nuk e kemi një mekanizëm të tillë, grupi multifunksional vijon të mbledhet, pra është në mbledhje të vazhdueshme.

A dëgjohem?

Bashkim Fino – Po vazhdo!

Ridvana Hysenbelliu – Pra, në vitin 2017 në e kemi firmosur marrëveshjen e bashkëpunimit me institucionet, duke filluar nga policia, spitali, domethënë të gjithë aktorët, ose faktorët që janë pjesë e këtij mekanizmi.

Bashkim Fino – Dëgjohen zërat e të tjerëve. Të lutem, mbylle derën kur je në zyrë! Thuaji të mbajnë pak qetësi atyre të Skraparit!

Ridvana Hysenbelliu – Na falni, se jemi në një sallë të madhe, prandaj dëgjohet.

Bashkim Fino – Thuaji të mbajnë pak qetësi, se po flasim me Kuvendin e Shqipërisë!

Ridvana Hysenbelliu – Na falni!

Bashkim Fino – Nuk ke faj ti. Vazhdo të lutem!

Ridvana Hysenbelliu – Mekanizmi funksionon në bashkinë e Skraparit, pavarësisht se ne nuk kemi një qendër ditore, që mund të jetë 72-orëshe për të pritur viktimat e dhunës. Ne kemi menduar që në rast se do të kemi një rast të tillë do ta akomodojmë në një ambient të konviktit të qytetit. Edhe në rastet kur na është kërkuar që a e kemi ngritur apo jo një strehë të tillë, për shkak se nuk kemi një qendër të tillë...

Bashkim Fino – Po flisni të gjithë atje. Zonjë të mirëkuptova për atë që the, gjithsesi do të kesh kontakt me Ministrinë e Shëndetësisë për të përmbushur të gjitha detyrimet që kemi në ligj

dhe, natyrisht, të marrim edhe shembujt e përparuar edhe të bashkive të tjera, që ti i dëgjove me shumë kujdes në këtë takim të sotëm.

Ju falënderoj edhe një herë për sugjerimet që thatë!

A ka kush dëshirë të shprehë mendimin e vet? Nëse nuk ka po ia kaloj fjalën koleges time Gjermani për të përmbyllur të gjithë këtë takim shumë efektiv sot.

Fjala për ju, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Shumë faleminderit!

Shumë faleminderit të gjithëve, kryetarë dhe staf bashkish, kolegë deputetë përfaqësues të shoqatave, patjetër të gjithë ju që jeni të angazhuar dhe punoni për një çështje kaq të rëndësishme, siç janë shërbimet sociale dhe në mënyrë të veçantë dhuna në familje! Besoj se problematikat, që u trajtuan janë pjesë e punës suaj dhe e rolit mbikëqyrës, që ka parlamenti dhe ne si nënkomisione jemi munduar të jemi sa më pranë ministrisë dhe bashkive. Gjetjet e këtij raporti që ju referuam, por edhe të raporteve të tjera, qoftë të bëra nga PNUD-i, programi i zhvillimit, qoftë nga UN Women, mekanizmat e dhunës janë ngritur në një pjesë të mirë të bashkive dhe falë raportimit të zëvendësministres janë tashmë 53 bashki dhe vetëm 8 bashki të vogla akoma nuk kanë krijuar mekanizmin e dhunës. Ne e bëmë mbledhjen jo vetëm si rol mbikëqyrës të parlamentit, por edhe për t'ju sensibilizuar, apo për t'ju treguar angazhimin dhe mbështetjen tonë, se dhuna në familje nuk është vetëm çështje ligjore, por është shprehje e të drejtave të njeriut, është përgjegjësi e secilit nga ne të zgjedhur, apo të votuar, apo të emëruar për ta trajtuar këtë çështje me përgjegjshmëri, duke respektuar të drejtat e njeriut dhe duke iu përgjigjur të gjitha angazhimeve ndërkombëtare që ka qeveria shqiptare. Ne i dimë sfidat e pushtetit vendor dhe shpeshherë buxhetet janë të limituara, por jo të gjitha çështje sociale kanë nevojë vetëm për buxhet. Për shembull, sistemi reval, sistemi në nivel kombëtar, ku duhet të hidhen të dhënat dhe ka përgjegjësi secili koordinator për dhunën në familje në nivel vendor, nuk besoj se ka nevojë për para ekstra. Pra është çështje përgjegjshmërie, angazhimi, vullneti politik nga kryetarët, nga këshillat e bashkive dhe nga të gjithë mekanizmat e referimit të dhunës.

Ne do të donim të theksonim në përmbyllje që të gjitha njësitë duhet të kenë mekanizmin e referimit të dhunës, duhet të kenë të ndarë koordinatoret për dhunën në familje nga koordinatoret për çështjet gjinore, ato vërtet janë të ndërlidhura, por kanë përgjegjësi më vete dhe koordinatoret për dhunën në familje do të jenë shpeshherë edhe menaxhues rastesh dhe kanë angazhime më të

mëdha në këtë fushë. Ndërsa ata që punojnë në fushën e barazisë gjinore kanë një problematikë tjetër dhe dhuna në familje është njëra prej tyre.

Unë kërkoj mirëkuptimin dhe angazhimin e të gjitha bashkive për t'i pasur të qarta dhe për t'i ndarë këto përgjegjësi, duke u dhënë mundësitë dhe hapësirën e nevojshme për të realizuar këtë detyrë. Ne sërish do të jemi në kontakt dhe do të organizojmë edhe një mbledhje tjetër për të parë rritjen e efikasitetit. Ndërkohë bashkitë e mëdha, të cilat i kanë krijuar këta mekanizma, sërish u sugjeroj që, për sa i përket dhunës në familje të rritet numri i koordinatorëve për të mbuluar rastet dhe problematikat. Është e pamundur që një person i vetëm të jetë koordinator, të paktën të jenë dy koordinatorë, që të angazhohen për ta trajtuar këtë problem, qoftë në parandalim, qoftë në referimin e rasteve të dhunës.

E vlerësoj shumë angazhimin tuaj dhe faktin që jeni këtu, si dhe çdo përpjekje, duke e ditur kërkesën, qoftë nga tërmetet, qoftë nga përmblytjet, qoftë nga pandemia për këtë çështje kaq të rëndësishme. Patjetër që do të keni mbështetjen tonë në buxhetim, që e tha edhe zoti Fino, të cilin e keni mbrojtës të flaktë të rritjes së buxhetit, por kërkojmë edhe vullnetin tuaj politik që bashkitë të mos buxhetojnë vetëm për infrastrukturë, por edhe për shërbime sociale.

Edhe një herë faleminderit!

Do të jemi sërish në kontakt dhe në bashkëpunim për t'ju mbështetur punën tuaj të përditshme.

Shumë faleminderit të gjithëve!

Bashkim Fino – Faleminderit!

E deklaroj mbledhjen e mbyllur dhe ju uroj një ditë të mbarë!

Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA

**Kryetar/
Sekretar**

**Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili**

Sekretare e komisionit